

GREEN COAST SH.P.K.

RRUGA "TISH DAIJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI

L41329038D

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 26.02.2024, në orën 12.30, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"),

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, këshilltar ligjor i shoqërisë, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtroi se kapitali aktual i Shoqërisë është 4,904,097,328 LEK (Katërmiliard e nentëqind e katërmilion e nentëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzetë e tete Lekë).

Me qëllim zhvillimin e projekteve të Green Coast 2 ka lindur nevoja e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Është vlerësuar e përshtatshme zmadhimi i kapitalit me 3,100,000 Euro (tre milion e njëqind mijë Euro) e konvertueshme me 321,718,000 LEK (Treqind e njëzetë e njëmilion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë Lekë) sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë të datës e mbajtjes së kësaj Mbledhje (**1 euro = 103.78 Leke**).

Vlera e zmadhimit do të shpërndahet përkatësisht për projektin :

- Green Coast 2 _ **Nukli G15** për vlerën 3,100,000 Euro

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja

VENDOS:

- A. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 3,100,000 Euro (tre milion e njëqind mijë Euro) e konvertueshme me me 321,718,000 LEK (Treqind e njëzetë e njëmilion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë Lekë) sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë të datës e mbajtjes së kësaj Mbledhje (**1 euro = 103.78 Leke**)**



- B. Bazuar në sa më sipër zmadhimi i kapitalit do të konsiderohet Kontribut ne Para dhe i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 4,904,097,328 LEK (Katermiliard e nenteqind e kater milion e nentedhete e shtate mije e treqind e njezete e tete Lekë) do të bëhet 5,225,815,328 LEK (Pesemiliard e dyqind e njezete e pese milion e teteqind e pesembedhete mije e treqind e njezete e tete Lekë).

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 13.00.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
GREEN COAST SH.P.K.**

KRYETARI


Znj. Edlira MUKA

SEKRETARI


Z. Bers Hado

